



QASJA NË EDUKIM TË HERSHËM PËR FËMIJËT: SFIDË PËR MAQEDONINË E VERIUT

HYRJE

Në një botë të dominuar nga teknologjia dhe lojërat e panumërta nëpër telefona smart, e ku fëmijët janë shpesh pre e gjithë kësaj teknologjie, kopshtet mbeten një mundësi ideale ku fëmijët mund të nisin të ecin me hapa të sigurt drejt zhvillimit të mirëfilltë kognitiv dhe social.

Kopshti është shkolla e parë e jetës për fëmijën, ku fëmijët mund të mësojnë komunikimin, bashkëpunimin, lidhjen e tyre me njerëzit dhe natyrën dhe ku mund të fillojnë të zhvillojnë ndërgjegjen e brishtë. Ekzistenca e kopshteve nënkupton egzistimin e mundësisë që një prind të gjej vendin ku mund t'i jep fëmijës atë që ndoshta nuk mund të ia jap vet, diku shkaku i punës dhe kufizimeve në kohë, e diku tjetër shkaku i më shumë fëmijëve dhe obligimeve tjera familjare.

Në këtë policy brief paraqesim gjendjen e kopshteve në Maqedoninë e Veriut, e më konkretisht japim përgjigjeve disa pyetjeve siç janë: sa kopshte ekzistojnë gjithësej? A ka mungesë apo tepriçë të vendeve në kopshte? Si qëndron Maqedonia e Veriut në aspekt të regjistrimit në shkollim të hershëm në krahasim me vendet tjera? Meqë disa nga të dhënat nuk janë publike Instituti për Demokraci dhe Analiza Ekonomike (IDEA) me 22 gusht dhe 3 nëntor 2023, ka bërë kërkesa për informacione me karakter publik deri tek Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në mënyrë që të shohim se si qëndron puna me kopshtet në Republikën e Maqedonisë duke marrë kështu përgjigje në shumicën e pyetjeve të parashtruara.

SI THEMELOHET NJË KOPSHT?

Sipas **Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve**, Neni 58, kopshti i fëmijëve mund të themelohet si kopsht publik dhe kopsht në pronësi private. **Kopshtin publik e themelojnë Qeveria dhe këshilli i komunës në Qytetin e Shkupit**, me vendim për themelimin e kopsht publik pas mendimit të marrë paraprakisht nga Ministria, gjegjësisht me propozimin e Ministrisë për Punë dhe Politikë sociale, për një kopsht publik të themeluar nga Qeveria. Kopshti publik themelohet si institucion publik, ai ka gjithashtu statutin që përcakton organizimin, mënyrën e punës, menaxhimin dhe udhëheqjen, etj.

Kopshti për fëmijë në pronësi private themelohet nga person fizik ose juridik, vendas apo i huaj. Kopshti për fëmijë në pronësi private themelohet si institucion privat për fëmijë, pra kopsht. Sipas Nenit 109 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, në aktin e themelimit të kopshtit privat, përcaktohen emri i themeluesit, emri i institucionit, selia, llojin e veprimtarisë, koha e veprimtarisë, të drejtat dhe detyrimet e themeluesit etj.⁽¹⁾

1.

<https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2021/%D0%97%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%B7%D0%B0%D1%88%D1%82%D0%B8%D1%82%D0%B0%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%B4%D0%B5%D1%86%D0%B0%D1%82%D0%B0%20%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D1%81%D0%BE%D0%BB%D0%B8%D0%B4%D0%B8%D1%80%D0%B0%D0%BD%20%D1%84%D0%B5%D0%B2%D1%80%D1%83%D0%B0%D1%80%D0%B8%202021-converted.pdf>

NUMRI I KOPSHTEVE

Kopshtet mund të jenë publike dhe private. Momentalisht në Maqedoninë e Veriut kemi gjithsej **81 kopshte publike** për fëmijë, të cilat janë të ndara në objekte kopshtesh, ose siç mund të shihet në figurën 1, kemi 63.1% ose 210 objekte kopshtesh në komuna urbane dhe 36.9% ose 123 objekte kopshtesh në komuna rurale. Kopshtet po ashtu janë të ndara dhe në 30 kushte të tjera hapësinore, që punojnë si pjesë e kopshteve publike komunale dhe 18 qendra për zhvillim të hershëm fëmijëror (nga të cilat 15 janë pjesë e institucioneve publike për fëmijë, dhe 3 janë qendra publike komunale). Ekzistojnë vetëm tre qendra private për zhvillim të hershëm të fëmijëve, edhe atë dy në qytetin e Shkupit dhe një në qytetin e Manastirit. Kemi shtatë çerdhe të cila bëjnë pjesë poashtu në institucione edukimi që kanë për detyrë rritjen dhe edukimin e fëmijëve deri në moshën tre vjeç dhe janë të organizuara si njësi organizative në kuadër të personave juridik, institucioneve të larta arsimore dhe shkollave private.

Sa i takon kopshteve private, kemi gjithsej **38 kopshte private** (5 në komunat me shumicë shqiptare edhe atë një në komunën e Çairit, dy në komunën e Tetovës dhe dy në komunën e Gostivarit). Pra nga tetëdhjetë komuna, në tridhjetë e tetë kemi kopshte private kurse në dyzet e dy nuk kemi asnjë kopsht privat për fëmijë.

Figura 1

Numri i kopshteve në komunat urbane vs komunat rurale, 2022



KOMUNAT KU NUK KEMI ASNJË KOPSHT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT


Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga gjithsej 80 komuna, 67 prej tyre kanë kopshte, kurse 13 nuk kanë asnjë kopsht. Prej komunave me shumicë shqiptare dhe me kryetar të komunës shqiptarë, kopshte kanë 9 komuna, kurse pesë të tjera nuk kanë asnjë kopsht në komunën e tyre edhe atë: Komuna e Haraçinës, Zhelinës, Studeniçanit, Tearcës dhe Bogovinës.

INVESTIMET NË NDËRTIMIN E KOPSHTEVE TË REJA

Në vitin 2022 janë bërë gjithsej **42 aplikime** në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) nga ana e komunave në Maqedoninë e Veriut për hapjen e kopshteve të reja ose përmirësimin e kopshteve ekzistuese. Kjo flet për nevojën e madhe për hapje të kopshteve të cilën komunat e përcjellin tek niveli qendror i qeverishes. Megjithatë, **nga gjithsej 42 aplikime vetëm 4 aplikime janë pranuar, edhe atë në komunën e Krivo Pallankës, Velesit, Kisella Vodës dhe Berovës.** Sipas përgjigjes së marrë nga MPPS, në procedurë është edhe ndryshimi i Programit për ndërtimin, paisjen dhe mirëmbajtjen e objekteve për fëmijët 2023, me të cilin parashihet paisja me inventar të çerdheve në fshatin Drenovë të komunës së Kavadarit dhe atë të fshatit Vratnicë të komunës së Jegunovcës.

Gjatë periudhës 2018-2022 nga komunat në MPPS janë dorëzuar gjithsej **223** aplikime për kopshte të reja ose për paisje me inventar të kopshteve ekzistuese, ndërsa janë bërë këto investime të cilat thuhet kanë krijuar gjithësej **7,599** vende të reja në kopshte:

Realizimi nga qeveria
65



Kërkesa nga komunat
223

Çerdhe të reja	Objekte të reja në kuadër të çerdheve ekzistuese	Rritje e kapaciteteve të objekteve ekzistuese
13	36	29

FËMIJË TË REGJISTRUAR NË KOPSHTË PËR VITIN 2021/2022

Në dhjetor të vitit 2022 në Maqedoninë e Veriut ishin **40,777 fëmijë të regjistruar në kopshte**, ndërsa numri i fëmijëve në pritje që të regjistrohen nëpër kopshte ishte gjithsej **5,695 fëmijë**. Ky numër ka rënë në **5,598 fëmijë** apo për 97 fëmijë, megjithatë kjo është një shkallë tepër e ulët e zvogëlimit të listës së pritjes (1,7%). Me këtë shkallë të zvogëlimit të listës së pritjes, do të duhen përafërsisht edhe 57 vite që lista e pritjes të arrijë 0.

Numri i madh i fëmijëve në pritje flet për mungesë të theksuar të kopshteve, e cila në fakt është edhe më akute nëse marrim parasysh edhe fëmijët të cilët nuk janë regjistruar në listën e pritjes por që do të ishin në çerdhe nëse do të ekzistonte mundësia.

Po ashtu, kalkulimet tregojnë që për vitin shkollor 2021/2022 për 1,000 fëmijë të regjistruar kishte rreth 8 objekte të kopshtve. Kjo shifër tregon se kemi një numër të madh të fëmijëve në raport me numrin e kopshteve, pra stërngarkim të kopshteve, duke e bërë situatën e nevojshme për më shumë resurse në fushën e arsimit parashkollor.

Figura 2

Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe i atyre në pritje, për vitin 2022




NUMRI TOTAL I TË PUNËSUARËVE, PUNËTORËVE DHE BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONAL

Figura 3 tregon numrin total të të punësuarve në kopshte siaps kategorisë. Siç mund të shihet, numri total i të punësuarëve nëpër kopshte është gjithsej **3,604** të punësuar, ku 1,322 të punësuar janë edukatorë dhe 2,073 janë kujdestarë. Numri i punëtorëve profesional është gjithsej 150 të punësuar, ku 27 janë defektolog, 37 logoped, 34 pedagog, 33 psikolog, 14 punonjës social, 4 mjek dhe 1 stomalog. Numri i bashkëpunëtorëve profesional 59 të punësuar, ku 3 janë mësues të artit, 26 mësues të muzikës, 10 mësues të edukimit fizik, 7 profesor për gjuhë të huaj dhe 13 motra medicinale.

Figura 3

Puntorë profesional në kopshte sipas kategorisë, 2022



REGJISTRIMI NË ARSIM DHE KUJDES TË HERSHËM


Regjistrimi i fëmijëve në arsimin e hershëm është një aspekt i rëndësishëm i politikave arsimore dhe zhvillimit të një vendi. Niveli i regjistrimit në këtë fazë të hershme të jetës ka ndikim të thellë në zhvillimin e fëmijëve, aftësitë e tyre kognitive, emocionale, dhe shoqërore.

Figura 4 për vitin 2020 tregon një dallim të ndjeshëm në nivelin e regjistrimit në arsimin e hershëm midis Maqedonisë së Veriut, vendeve të Ballkanit Perëndimor, OECD-së dhe shteteve të Bashkimit Evropian. Një nivel i regjistrimit i ulët në Maqedoninë e Veriut, vetëm 41%, në krahasim me 81% të nivelit të OECD dhe pothuajse 100% të vendeve të BE-së, tregon nevojën për përmirësime në fushën e arsimit të hershëm në vend. Faktorë të ndryshëm ndikojnë në nivelin e regjistrimit, përfshirë qasjen në çerdhe publike, politikat arsimore, faktorët socio-ekonomik, ndërgjegjësimin e prindërve rreth rëndësisë së edukimit të hershëm, etj.

Për ta rritur nivelin e regjistrimit, është e rëndësishme të kultivohet bashkëpunimi midis qeverisë, shoqërisë civile dhe prindërve. Niveli i lartë i regjistrimit në arsimin e hershëm mund të ndihmojë në rritjen e potencialit të fëmijëve, si dhe mund të lehtësojë prindërve, rrespektivisht nënave, që të kyçen në tregun e punës apo të ndërmarrin aktivitete tjera me rëndësi për ta.

Figura 4

Përqindja e fëmijëve të moshës 3-5 vjeç të regjistruar në shkollim të hershëm



Burimi: OECD (2022), Rishikim shumëdimensional i Ballkanit Perëndimor: Nga Analiza në Veprim, Rugët e Zhvillimit të OECD, Botim i OECD, Paris, <https://doi.org/10.1787/8824c5db-en>.

PËRFUNDIM

Përmbledhja e situatës së kopshteve në Maqedoninë e Veriut tregon një peizazh të pasur, por edhe të sfidueshëm. Me 81 kopshte publike dhe 37 private, numri i tyre nuk përshtatet gjithmonë me nevojat e fëmijëve, duke sjellë një raport të ulët midis numrit të fëmijëve dhe numrit të kopshteve.

Për vitin 2021/2022, 40,777 fëmijë ishin të regjistruar në kopshte, ndërsa 5,695 prisnin të regjistroheshin. Kjo tregon se është e nevojshme të ndërmerren masa për zgjerimin e kapaciteteve. Në këtë kontekst, iniciativa e komunave për hapjen e kopshteve të reja është hapi i duhur drejt ofrimit të më shumë mundësive për fëmijët. Gjithashtu, roli i të punësuarëve në kopshte, përfshirë edukatorëve, kujdestarëve dhe profesionistëve të ndryshëm, është kyç për sigurimin e kujdesit dhe edukatës cilësore për fëmijët.

Në një botë ku teknologjia ka pushtuar jetën e fëmijëve, kopshtet mbeten një oaz i rëndësishëm për zhvillimin e tyre emocional dhe intelektual. Për të përmbushur këto sfida dhe për të ofruar një bazë të fortë për fëmijët e tyre, autoritetet duhet të vazhdojnë të investojnë dhe të përmirësojnë infrastrukturën dhe cilësinë e kujdesit në kopshte.



Instituti për Demokraci dhe Analiza Ekonomike – IDEA është “think tank” i krijuar në mars të vitit 2023 në Shkup, me mbështetjen e European Endowment for Democracy.

Në esencë, ne besojmë se forca e demokracisë tonë dhe cilësia e politikave ekonomike janë ngushtë të lidhura me angazhimin dhe pjesëmarrjen tonë demokratike. Ky besim i palëkundur ushqen qëllimin tonë, si ekip i përkushtuar për të kontribuar në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të demokracisë dhe politikave ekonomike në Maqedoninë e Veriut.

Ne e përfytyrojmë Maqedoninë e Veriut si një shtet anëtar progresiv, liberal dhe rezilient i Bashkimit Evropian i cili është i ndërtuar mbi gjithëpërfshirje, inovacion dhe qëndrueshmëri. Ne jemi këtu për ta avancuar demokracinë dhe për të nxitur zhvillimin!

www.idea.org.mk

Tetovska 33/2/7 , Skopje, Republic of Macedonia

+389 70 985 729